Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Guri	**16.08.2023**	**28.08.2023**	**2023/0574**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 14.08.2023, OE "Samire Osmani"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0574, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Samire Osmani"- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material Higjeniko - Sanitar" me nr. të prokurimit: "651-23-394-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL- GJILAN. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 126,836.80 €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0574 i dt:14.08.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 48 pika 1,2,3 dhe 4 e Ligjit per Shoqeri Tregtare.Biznesi Individual nuk eshte person juridik i njejti biznes lidhet me individin pra me vdekjen e pronarit te biznesit individual shuhet edhe veprimtaria e biznesit .dhe ne asnje forme nuk guxohet te ushtrohet veprimtaria edhe nese ndonje anetare i familjes posedon ndonje autorizim ai autorizim mund te perdoret per ushtrim te veprimtarise se biznesit deri ne diten e vdekjes ne te kunderten eshte Veper Penale .Poashtu kemi shkelje edhe te shume Neneve te LPP-se si ne viji\\m; ,Neni 1 paragrafi 1,2 dhe 3 ,Neni 2 ,Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti paragrafi 1 dhe 2,Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale.

Pretendimi numer 1.

AK-Komuna e Gjilanit permes Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit per OE SAMIRE OSMANI B.I permes emailit me date 21.03.2023 ku ne si OE me date 22.06.2023 permes platformes e prokurimi i kemi derguar sqarimet e kerkuara dhe duke ja bashkeangjitur me faktura te blerjes per qdo pozicion qe ka kerkuar dhe AK pra i njejti AK eshte bindur dhe me date 04.04.2023 na ka shpallur fitues neve si OE ndersa pas Rivleresimit me date 26.07.2023 te Vendimit nga AK nuk qenka bindur Komisioni tjeter.Kjo eshte per qudi pasi qe tendeca e AK nuk eshte bindja per pozicione por bindja e tyre eshte shkelja e rend e ligjit te LPP-se dhe te shperblejne nje kompania qe eshte me qmim me te larte rreth 11 mije se sa ne qe kemi ofertuar.Me plote bindje deklaroj se qdo pozicion i kerkuar eshte artikulluar ne menyre bindese duke ja abshkeangjitur edhe fakturat e blerjes.Per me shume shikoni arsyetimet dhene te dates se lartecekuar dhe asgje nuk kam per te shtuar me shume se aq sepse ju AK po beni diskrimine territoriale vetem evetem te favorizoni nje kompani te caktuar.

Shkelja numer 2;

AK ne vendim e dates 26.07.2023 dhe poashtu ne Vendimin per Rishqyrtim te dates 02.08.2023 ne Arsyetim per Refuzim nuk paska ditur as qe te shkruaaj pasi qe i paska humbur rruga ne oborr dhe per informimin e AK mua si OE nuk me eshte kerkuar sqarime per pozicioni me numer rendor 30 te dates qe po e permendin me artikullin me pershkrim Fshise me bishte te gjate (plastike ose druri) andaj nga e kane shpikur kete sqarim nuk e dine as ata vet sepse nje gje e tille nuk me eshte kerkuar .Edhe eksperti edhe Panelli Shqyrtues mund te vertetojne se kjo vetem eshte shpikje se per kete pozicion nuk me eshte kerkuar sqarime dhe rrjedhimisht ne arsyet per eliminim permendet edhe kjo arsye per eliminim.Andaj ti behet e qarte AK se nga ka ardhur ky konkludim apo e kane shpikur nga mendja e tyre si arsyetim.

Shkelja numer 3;

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit permend qe jemi qmim jo nomalisht i ulet per disa pozicione qesharake .Po ja permendi juve eksperti i nderuar dhe Panellit Shqyrtues qe per disa pozicione te Sqarimeve qe kane kerkuar e me date 23.03.2023 i jam pergjigjur AK qe per pozicionet me numer 14,15,16 dhe 60 ne permes fakturave te blerjes i kemi deshmuar AK se edhe pse i eshte dukur qmimin jo nomalisht i ulet i kemi deshmuar qe fitimin e kemi mbi 60 % per qdo pozocion e qe eshte qmimin jashtezakonisht i larte. Ndersa sa i perket arsyetimit per pozicionin me numer renor 93 Gjoker me shpuze (me mekanziem komplet) i kam bashkeangjitur faktur per kete pozicion por pershkrimi ne fakture ska qene komplet dhe jo bindes sipas tyre POR POR shiko fakturen e blerjes te prodhuesi numer 1 ne KOSOVE CADI GROUP SHPK me numer faktures 3350-2023 te dates 30.06.2023(shif fakturen si deshmi ne kete ANkese) ku qmimi blerjes eshte 1.85 euro ndersa une per sasin 87 copa (sasi qesharake per eliminim) kam aplikuar ne qmim prej 2 euro copa qe dmth prap jam me fitim solid .Si eshte e mundur te behet nje manipulim i tille .Per kete kam deshire me fakte dhe argumente te ballafaqohem me AK ne seace ne OSHP-e.. Per te hequr dilemat sa kushton ky produkt mund te vizitoni edhe vete CADI GROUP SHPK qe qmimi real i gjokerit me shpuze me mekanziem komplet te shtrydhjes kushton me kete qmimin qe ju prezentova .Andaj kerkoje qe me keta manipulant dhe shkeles te ligjit te ballafaqohem me fakte dhe argumente qe per qdo pozicion dhe me mostra mund ti sjelli ne seance te OSHP-se qe jane produkteve shume kualittive dhe ashtu siq i ka kerkuar AK .Keto praktika e keto shatanzhe duhet nje here e mire permes

vendimeve te OSHP-se ti behet e ditur AK qe mos te shkelin ne menyre flagrante ligjin pasi qe faktet dhe argumentet i kam ne menyre te bollshme per te fituar kete lende ne menyre 100% andaj shpresoj qe ne menyre te drejte edhe eksperti edhe Paneli Shqyrtues ti analizojne mire keto argumente.

Shkelja numer 4;

GOE CONSORTIUM OFFISHOP GROUP SHPK & NTP VLORA edhe pse me qmim ka qene mbi 11 mije euro me i shtrejt se ne eshte shpallur fitues kunderligjshem pasi qe anetari i konserciumit NTP VLORA konkretisht eshte futur ne konsercium si emer tregtar ndersa biznes real eshte Adnan Krasniqi B.I me adrese Prishtine ,L.Dardania -RR.Bi Deshmoreve me Numer Unik te Biznesit 810468860 pronar ka qene Adan Krasniqi i cili tashme eshte i ndjere ndersa tani figuron si agjente e regjistruar Vlora Krasniqi andaj kjo eshte ne kundershtim me Neni 48 pika 1,2,3 dhe 4 e Ligjit per Shoqeri Tregtare.Biznesi Individual nuk eshte person juridik ,i njejti biznes lidhet me individin pra me vdekjen e pronarit te biznesit individual shuhet edhe veprimtaria e biznesit .dhe ne asnje forme nuk guxohet te ushtrohet veprimtaria edhe nese ndonje anetare i familjes posedon ndonje autorizim ai autorizim mund te perdoret per ushtrim te veprimtarise se biznesit deri ne diten e vdekjes ne te kunderten eshte Veper Penale.

Argumenti numer 5;

AK –Komuna e GJilanit ka perdorur edhe metoden qe para dhenjes se Kontrates te na kerkoje edhe sigurmine e tenderit ne masen 30% pasi qe kinse argumentet tona nuk e kane bindur AK dhe Komisionin e Vleresimit se do te bejme realzimin e Kontrates. Pra edhe perkunder zotimit tone ne kemi kerkuar Interpretimin nga KRPP-ja permes nje shkrese zyrtare dhe me date 29.03.2023 KRPP-ja i ka dhene te drejte argumentit tone e per kete shif deshmin në platformën e-prokurimi, në linkun: "Informacione" në vegzën "INTERPRETIME", Pyetja me numër 21.

Pra tendeca e AK qe nga fillimi ka qene eliminimi jone nga ky aktivitetet i prokurimit ku permes ketyre "metodave te quaj shantazhuese ligjore qe ia mundeson ligjin na kan deskridutuar dhe na kan lodhur nga ky aktivitet i prokurimit" por ne nuk do te dorzohemi dhe deri ne piken e fundit do te luftojme kete padrejtesi.Pra AK duke e pare qe nuk i dhezi as me kete metode e neglizhoj procesin sa me ska aq sa kerkoje edhe Ri Sigurimin te dorzimit te ofertes duke shkaktuar shpenzime e duke luajtur me te gjithe OE pjesemarres. Pra permes kanaleve jo zyrtare kam marre informacione se tendenca e AK ka qene qe te shpalle fitues kompanine nga Gjilani e cila ka lidhje e ndikime te medha ne kete komune e qe per kete nga muaji Mars 2023 e kam njoftuar Institucionet e Gjyqesise per keto pretendimet tona mirpo tash po del qe ky nuk ka qene vetem pretendim mirpo synim i AK.

Shkelja numer 6;

AK edhe perkunder shume shkeljeve te renda ne oferten tona e ka shpallur kunderligjshem fitues nje firme e i cili pronari i firmes eshte i vdekur dhe poashtu qe nuk i plotesojne te gjitha kriteret e kerkuara ne dosje te tenderit pasi qe nuk e plotesojne kriterin kryesore :Lista e kontratave dhe Referencave eplotesuar dhe nenshkruar sipas Ankesit 6 te DT ne vlere minimumi 100,000.00 euro.

Sheklja numer 7;

Operatori Ekonomike SAMIRE OSMANI B.I ne sqarimet e derguara tek AK me date 23.03.2023 ka dhene Deklarate nen Betim dhe asaj deklarate ende i qendrojme se do ti bejme te gjitha furnizimet sipas specifikave te Kerkuara nga AK dhe do ti bejme sipas standarteve te kerkuara dhe me bindje te plote me fakte dhe argumente te plota asnje pozicion te kontrates nuk e kemi me qmim jo nomalisht te ulet dhe me bindje te plote dhe ne menyre te argumentuar Panelit Shqyrtues gjate mbajtjes se seances do ti paraqesim fakte origjinale me faktura dhe me mostra qe produkteet tona jane kualitative dhe nuk jane produkte me qmime jo nomalisht te uleta jo per krejt tenderin qe nuk behet fjale por per asnje pozicion te vetem .Poashtu jap deklarim nen betim se per tere oferten tone ne vlere pas korogjimit 70,064.40 euro qe FITIMI BRUTO I KOMPANISE NE KETO OFERTE ESHTE NE VLERE 19,870,65 EURO andaj kerkoje drejtesi nga Paneli Shqyrtues ne te kunderten do te detyrohem qe drejtesim te kerkoje permes institucioneve tjera te drejtesise. JU FALIMINDERIT !

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Kërkesa 1. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik nëregjistrin profesional, komercial dhe aporegjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.

Kërkesa 2. Regjistrimi i TVSH;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1. Certifikata e regjistrimit te biznesit – kopje

Dëshmia 2. Certifikata e TVSH-sëkopje.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kërkesa 1 OE duhet te ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE, gjate 3 viteve te fundit ka qene ne vlere, se bashku ne te tri vitet, prej jo me pak se 100,000.00.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1 Deklaratat Tatimore vjetore te dorëzuara ne ATK për tri vitet e fundit.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se ngjashme gjate 3 vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontrat. Në një vlere prej jo me pak se 100.000,00 €.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Me qene se kriter per dhenjen e kontrates eshte tenderi i pergjegjshem me cmim me te lire, ateher Komisioni i vleresimit rekomandon Zyrtarin pergjegjes te Prokurimit qe me kontrate ta shperblej Operatorin Ekonomik Offishop Group SH.P.K. N.T.P. VLORA ne vlere prej 81,885.37 €.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Samire Osmani**

Sqarim fillestar lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me material Higjeniko - Sanitar", me nr. te prokurimit: 651-23-394-1-1-1.**

Fillimisht eksperti shqyrtues sqaron se pretendimet kryesore ankimore kane te bëjnë me eliminimin e ofertës së OE ankues pas procesit te rivlerësimit fillestar te ofertave përkatësisht njoftimin mbi rezultatin nga aktiviteti i prokurimit te publikuar nga **AK Gjilan** me datën 04.04.2023. AK si arsyetim te eliminimit ka përcaktuar se OE ankues **"Samire Osmani",** për disa nga pozicionet e caktuar ka ofertuar me çmime Jo Normalisht te ulëta siç përcaktohen me nenin 61 te LPP-se.

OE ankues përmes deklaratës ne ankese dhe përmbajtjes tekstuale te saje, kryesisht ka përshkruar vargje dhe fraza me karakter te vërejtjeve, leksioneve dhe kërcënimeve për mënyrën e zhvillimit dhe procesit te vlerësimit dhe rivlerësimit te kësaj procedure te prokurimit dhe shume pak i është referuar objektit te kontestit.

Përgjigjet në pretendimet ankimore;

Sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me arsyetimin e eliminimin e OE ankues sqarojmë se përgjatë vlerësimit fillestar te ofertave AK Komuna Gjilan përmes formës standarde te KRPP-se – Letrës Standarde, kërkesës për sqarime te tenderit i është drejtuar OE ankues për sqarim te disa nga pozicioneve te paramases duke i konsideruar ato si çmime Jo Normalisht te ulëta. Pas ofrimeve te sqarimeve AK Komuna Gjilan, publikon njoftimin mbi rezultatin e aktivitetit te prokurimit dhe rekomandon për dhënie te kontratës OE e njëjte, me gjithë atë OE prape paraqet kërkesë për rishqyrtim e njëjta kërkesë aprovohet dhe procesi kthehet ne rivlerësim. Pas procesit te rivlerësimit te tej zgjatur nga AK me dt. 26.07.2023, publikohet njoftimi pasues ku tani OE ankues eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se për pozicionet e caktuara ka ofertuar me çmime Jo Normalisht te ulëta.

Neni 61 i LPP-se parasheh procesin qe AK-te duhet te ndjekin për ta konsideruar një oferte si Jo Normalisht te ulet, ndërsa neni 41 i Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022, trajton ne mënyrën edhe me te qartë çështjen e tenderëve Jo Normalisht te ulet.

Sipas paragrafit 5 te nenit 41, *përcaktohet qe: kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ulet ne pajtim me nenin 61 te LPP-se dhe paragrafit 41.3 ose 41.4 te kësaj rregullore, një tender i tillë nuk mund te refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve te rëndësishme qe shkaktojnë tenderin veçanërisht te ulet.*

AK sipas letrës standarde dhe arsyetimit te eliminimit te OE ankues rezulton qe ka përshkruar pozicione te paramases dhe i ka konsideruar ato pozicione si çmime Jo Normalisht te ulëta pa kërkuar sqarim fare ndaj OE ankues. Shembull **pozicioni nr. 30** i paramases dhe parallogarisë.

Lidhur me pretendimin tjetër ankimor kundër OE te rekomanduar për dhënie te kontratës sa i përket anëtarit te grupit te OE **NTP "Vlora"**, OE ankues i referohet dispozitave ligjore te ligjit për Shoqëri Tregtare, përkatësisht pohon se pronari i te njëjtit biznes ka ndërruar jete dhe bashke me ta shuhet edhe vete biznesi.

Sipas certifikatës se regjistrimit te biznesit e ngarkuar ne oferte rezulton qe kemi te bëjmë me biznes individual por eksperti shqyrtues nuk posedon kurrfarë prove lidhur me faktin se nëse pronari i te njëjtit biznes ka ndërruar jete. Sipas nenit 48 te LIGJI Nr. 06/L -016, për Shoqëritë tregtare neni 1 përcakton:

1. Një person mund të ketë vetëm një Biznes Individual. Personi i cili është pronar i një Biznesi Individual, ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të shkaktuara, ose të imponuara nga një ligj ose kontratë, në një Biznes Individual. Kjo përgjegjësi është e pa-kufizuar dhe përfshin tërë pronën dhe asetet e çfarëdo lloji që janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të këtij Personi, pavarësisht nga fakti se nëse prona ose asetet e tilla shfrytëzohen për qëllime afariste, personale apo shtëpiake, përveç pronës ose aseteve të përcaktuara në ligjin në fuqi për procedurën përmbarimore, dhe kur:

1.1.kontrata e cila e ka krijuar këtë përgjegjësi shprehimisht e përjashton nga përgjegjësia pronën ose asetet;

1.2. personi ose shoqëria tregtare që ka pretendime është pajtuar që këto asetet ose prona të mos i nënshtrohen pretendimeve të tij.

Prandaj, eksperti shqyrtues sipas asaj qe u përshkrua me lartë dhe ne kuptim te nenit 59 dhe 72 te LPP-se, vlerëson se ky proces i prokurimit duhet te kthehet ne rivlerësim ne atë mënyrë qe AK ti aplikoj ne tersi dispozitat e nenit 61 te LPP-se, si dhe nenit 41 te RRPP-se, sa i përket çmimeve dhe pozicioneve te cilat mund te duken apo edhe janë si Jo Normalisht te ulëta, ndërsa lidhur me qeshjen e vdekjes se pronarit te biznesit individual te kërkohet sqarim apo te konsultohet baza ligjore nëse biznesi mund te trashëgohet si tërësi, mund te trashëgohen vetëm asetet apo me vdekjen e pronarit shuhet edhe vete biznesi, konkretisht te kërkohet sqarim nga anëtari i grupit NTP "Vlora", lidhur me statusin e biznesit me qe ne ARBK biznesi i njëjtë rezulton te jete aktiv.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Samire Osmani**

Burim Guri